

VENDIM
Nr. 420, datë 26.6.2024

PËR TRAJTIMIN ME PAGË DHE SHTESA MBI PAGË TË USHTARAKËVE
AKTIVË TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

(Ndryshuar me VKM nr. 619, datë 10.10.2024; nr. 126, datë 27.2.2026)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “a”, të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 35/2023, “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”, dhe të nenit 20, të ligjit nr. 9210, datë 23.3.2004, “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në fushën e veprimit të këtij vendimi përfshihen:
 - a) ushtarakët e shërbimit aktiv në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë: oficerë aktivë, nënoficerë aktivë dhe ushtarë aktivë;
 - b) kursantët, kandidatët për ushtarë.
2. Elementet përbërëse të pagës për ushtarakët e shërbimit aktiv në Forcat e Armatosura, me përjashtim të ushtarakëve aktivë të personelit akademik në Akademinë e Forcave të Armatosura, janë, si më poshtë vijon:
 - a) paga bazë për gradë, që shpërblen vlerën relative të çdo grade, sipas hierarkisë së gradave dhe sipas viteve të shërbimit për oficerët aktivë, nënoficerët aktivë dhe ushtarët aktivë;
 - b) shtesa për kushte të veçanta pune e shërbimi, që aplikohet në një vlerë të caktuar, bazuar në pozicionet e punës, kur ushtarakët e shërbimit aktiv punojnë në pozicione pune të një natyre të veçantë pune e shërbimi;
 - c) shtesa për dëmshmëri shëndeti, që aplikohet në një vlerë të caktuar, kur ushtarakët e shërbimit aktiv punojnë në pozicione pune në kushte të vështira dhe të dëmshme për shëndetin.
3. Elementet përbërëse të pagës për ushtarakët aktivë të personelit akademik në Akademinë e Forcave të Armatosura janë, si më poshtë vijon:
 - a) paga për titull akademik/gradë shkencore/kualifikim shkencor, që shpërblen vlerën relative të çdo pozicioni, sipas hierarkisë së pozicioneve të punës, në institucionet e arsimit të lartë publik;
 - b) shtesa për vjetërsi në punë, që aplikohet për çdo ushtarak të shërbimit aktiv, të personelit akademik, në Akademinë e Forcave të Armatosura, bazuar në vitet e punës së çdo ushtaraku, dhe llogaritet në masën 0,5 (zero presje pesë) % për çdo vit pune, por jo më shumë se 15 (pesëmbëdhjetë) vjet;
 - c) shtesa për kushte të veçanta pune dhe shërbimi.
4. Vlerat e elementit “pagë bazë për gradë”, sipas gradës dhe viteve të shërbimit, për ushtarakët e shërbimit aktiv të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, janë sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
5. Vlerat e elementit “pagë për titull akademik/gradë shkencore/kualifikim shkencor”, sipas gradës ushtarake dhe pozicionit të punës, për ushtarakët e shërbimit aktiv, të personelit akademik në Akademinë e Forcave të Armatosura dhe masa e shtesës për kushte të veçanta pune e shërbimi për ta, janë sipas lidhjes nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

6. Masat e shtesës për kushte të veçanta pune e shërbimi për ushtarakët e shërbimit aktiv të Forcave të Armatosura përcaktohet, si më poshtë vijon:

a) për ushtarakët e shërbimit aktiv të personelit fluturues dhe mbështetës të fluturimeve, të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, përcaktohet sipas lidhjes nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

b) për ushtarakët e shërbimit aktiv në Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes përcaktohet sipas lidhjes nr. 4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Pozicionet për të cilat zbatohet kjo shtesë, në funksione operacionale, operacionale mbështetëse dhe mbështetëse, në Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, përcaktohen në urdhrin e Kryeministrit për miratimin e strukturës e të organikës së kësaj agjencie;

c) për ushtarakët e tjerë të shërbimit aktiv të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të cilët nuk janë pjesë e lidhjeve nr. 3 dhe nr. 4, me përjashtim të ushtarakëve të shërbimit aktiv të personelit akademik, me tituj akademikë dhe grada/kualifikime shkencore, përcaktohet sipas lidhjes nr. 5, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

7. Masa e shtesës mbi pagë për punë të vështira e të dëmshme për shëndetin, për ushtarakët e shërbimit aktiv të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të cilët punojnë në vende të vështira pune, përcaktohet sipas lidhjes nr. 6, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Ushtarakët, funksioni i të cilëve përmban dy apo më shumë emërtime, që përfitojnë shtesë për punë të vështirë e të dëmshme në shëndet, trajtohen vetëm me një shtesë, sipas kësaj lidhjeje.

8. Ushtarakët e shërbimit aktiv, në Njësinë e Mjekësisë Ushtarake, pranë Spitalit Universitar të Traumës, që janë të emëruar në pozicionet “drejtor”, “zëvendësdrejtor”, “shef shërbimi” apo “shef reparti”, shtesën për punë të vështirë e të dëmshme për shëndetin e përfitojnë sipas specialitetit dhe jo sipas pozicionit, ku janë emëruar.

9. Ushtarakët e shërbimit aktiv të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të cilët punojnë në pozicione, që lidhen me procesin e informatizimit të veprimtarisë së Forcave të Armatosura, pjesë të strukturave të TIK-ut, si dhe kërkojnë, në mënyrë të detyrueshme, diplomë universitare të nivelit “Master i shkencave/Master profesional/Bachelor” apo të barasvlershme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë, në degët “Inxhinieri elektronike”, “Inxhinieri informatike”, “Informatikë”, “Teknologji informacioni”, “Inxhinieri telekomunikacioni”, “Shkenca kompjuterike”, “Informatikë ekonomike” “Informatikë biznesi”, “Inxhinieri matematike informatike” apo “Inxhinieri matematike (në analiza sistemesh)”, përfitojnë shtesë për natyrë të veçantë pune, në masën 7 500 (shtatë mijë e pesëqind) lekë në muaj.

Zbatimi i shtesave si më sipër për pozicionet konkrete bëhet pas miratimit paraprak të Departamentit të Administratës Publike, bazuar në përshkrimin e pozicionit të punës.

Në rast se për pozicionet e sipërpërmendura, nëpërmjet këtij vendimi, parashikohen shtesa të tjera për kushte të veçanta pune e shërbimi, oficerët aktivë do të zgjedhin ndërmjet dy shtesave, por, në asnjë rast, nuk mund t’i përfitojnë të dyja shtesat.

10. Kursantët, kandidatë për ushtarë, gjatë kohës që ndjekin kurset për t’u certifikuar “ushtar”, përfitojnë trajtim me pagesë në masën 8 000 (tetë mijë) lekë në muaj.

11. Ushtarakët aktivë të Forcave të Armatosura nuk përfitojnë shtesa të tjera mbi pagë të përcaktuara me vendime të tjera të Këshillit të Ministrave.

12. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i të këtij vendimi, për vitin 2024, të përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes, për vitin 2024.

13. Vendimi nr. 224, datë 21.3.2017, i Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të ushtarakëve aktivë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, shfuqizohet.

14. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 korrik 2024.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

(Ndryshuar me VKM nr. 126, datë 27.2.2026)

Lidhja nr.1

[illegible]

(Ndryshuar me VKM nr. 126, datë 27.2.2026)

Lidhja Nr. 2

STRUKTURA DHE NIVELI I PAGAVE PËR USHTARAKËT AKTIVË TË PERSONELIT AKADEMIK,
NË AKADEMINË E FORCAVE TË ARMATOSURA

Nr.	Grada ushtarake	Pozicioni	Paga për titull akademik/gradë shkencore/kualifikim shkencor	Masa e shtesës për kushte të veçanta pune e shërbimi
1	Gjeneral Brigade/Major	Rektor me titullin “Profesor”	184,000	10,000
2	Kolonel (kapiten i rangut I)	Zëvendësrektor, me titujt “Profesor”/ “Profesor i Asociuar”	174,100	10,000
3	Kolonel (kapiten i rangut I)	Zëvendësrektor, me gradën shkencore “Doktor(PHD)”	171,720	10,000
4	Kolonel (kapiten i rangut I)	Dekan me titujt “Profesor”/ “Profesor i Asociuar”	174,100	10,000
5	Kolonel (kapiten i rangut I)	Zëvendësdekan me titujt “Profesor”/ “Profesor i Asociuar”	159,300	10,000
6	Kolonel (kapiten i rangut I)	Zëvendësdekan nga kategoria “Lektorë”	140,490	10,000
7	Kolonel (kapiten i rangut I)	Përgjegjës i njësisë bazë me titujt “Profesor”/ “Profesor i Asociuar”	163,000	10,000
8	Kolonel (kapiten i rangut I)	Përgjegjës i njësisë bazë nga kategoria “Lektorë”	140,490	10,000
9	Kolonel (kapiten i rangut I)	Titullar i grupit mësimor - kërkimor nga kategoria “Profesor”/ “Profesor i Asociuar”.	163,000	10,000
10	Nënkolonel (kapiten i rangut II)	Titullar i grupit mësimor - kërkimor nga kategoria “Lektorë”	140,490	10,000
11	Kolonel (kapiten i rangut I)	Profesor	159,300	10,000
12	Nënkolonel (kapiten i rangut II)	Profesor i Asociuar	138,400	10,000
13	Nënkolonel (kapiten i rangut II)	Lektorë	118,940	15,000
14	Major (kapiten i rangut III)	Asistent Lektorë	96,600	15,000
15	Kapiten Lejtnant)	Asistent Lektorë	87,700	15,000

Masa e shtesës për kushte të veçanta pune e shërbimi, për ushtarakët e shërbimit aktiv të personelit fluturues dhe mbështetës të fluturimeve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë

	Pozicioni	Masa e shtesës mujore në lekë për muaj					
		Në repartet/ bazat ajrore operacionale, që kanë helikopter në TOP	Në repartet/ bazat ajrore operacionale të varësisë së FAJ, që kanë helikopter në TOP	Në repartet/ bazat ajrore operacionale	Në komandën dhe në strukturat e tjera të Forcave Ajrore	Në Detashmentin UAV të Forcave Ajrore	Në strukturat e tjera të Forcave të Armatosura
N r.	1	2	3	4	5	6	7
1	Ushtarakët aktivë në funksionet organike: Pilot Instruktur/Kontrollor Fluturimi/Pilot Kolaudator-H. Komandant/zëvendëskomandant/shef/specialist në: Komandë/Shtab/Skudron/Grup, të cilët disponojnë dëshmitë/kualifikimet/diplomën/akt për ushtrimin e këtyre të drejtave.	100,000					
2	Ushtarakët aktivë në funksionet organike: Pilot Instruktur/kontrollor F l u t u r i m i - H . Komandant/zëvendëskomandant/Shef/specialist në: Komandë/Shtab/Skudron/Grup, të cilët disponojnë dëshmitë/kualifikimet/diplomën/akt për ushtrimin e këtyre të drejtave.				60,000		
3	Ushtarakët aktivë në funksionet organike: Pilot Komandant Ekuipazhi-H. Komandant/zëvendëskomandant/Shef/specialist në: Komandë/Shtab/Skudron/Grup, të cilët disponojnë	90,000			50,000		30,000

	dëshmitë/kualifikimet/diplomën/a t për ushtrimin e këtyre të drejtave.						
4	Ushtarakët aktivë në funksionet organike: Pilot-H. Komandant/zëvendëskomandant/Shef/specialist në: Komandë/Shtab/Skuadron/Grup, të cilët disponojnë dëshmitë/kualifikimet/diplomën/a t për ushtrimin e këtyre të drejtave.		80,000		40,000		
5	Pilot dhe Pilot UAV. Shef seksioni i kontrollit dhe standardizimit, oficer i komandimit të misionit/kontrollit të fluturimit, kontrollit të fluturimit pilot dhe standardizimit të UAV, shënjues, operator ngarkese.				30,000	45,000	25,000
6	Oficer Inxhinier aviacioni/fluturimi/helikopteri.			40,000	30,000		
7	“Anëtarë/ekuipezhi/bordi”-H. “Teknik mekanik/Aeroshpëtues/Vinçier/Navigator/Mitralier”-H.	45,000					
8	Teknik aviacioni/Helikopteri (Skuadron/Grupet e fluturimit, në seksione dhe komandë, ushtarë/nënoficerë/oficerë). Teknik mekanik në Qendrën e Mirëmbajtjes (Specialist motori, strukturë avionike, armatim/radio/pajime elektrike/riparues helikopteri etj. - H ushtarë/nënoficerë/oficerë).			40,000	30,000	40,000	25,000
9	Kryekontrollor. Kontrollor të trafikut ajror. Kryekontrollor. Kontrollor të mbrojtjes ajrore.	40,000			30,000		
10	Ushtarakët aktivë në funksione organike për shërbimet tekniko-operacionale të radarëve të vëzhgimit të hapësirës ajrore. Funksionet organike në Qendrën e Komandimit dhe Monitorimit të Avionëve pa pilot (antidron).				30,000		
11	Mekanik/specialist/motori në strukturat avionike/armatimit. Shef qendre, specialist mekanik/motorist, specialist/elektrik/elektronik/speci	25,000				25,000	

	alist armatim-municioni dhe rezervës UAV. Specialist/analist imazherie (operator harte, navigator). Shef seksioni dhe teknik terminali të dhënash/kontrollit tokësor UAV (operator harte, navigator). Magaziniër/administrator i teknikës ajrore. Teknik (motorist/mekanik/elektrik/eletro nik/terminali).						
1 2	Në funksionet organike: - në seksionet e vend instalimit të radarit TPS-77/VQ-PRT/setet Mikrovalor/GAG. - Komandant/zëvendëskomandant reparti 3003. në komandën dhe shtabin e UAV-së.				25,000	25,000	
1 3	- Ndihmëskontrollor/ndihmësasistent.				20,000		
1 4	Në funksionet organike në pozicione mbështetëse, - në UAV; - të MNZSH (shofer autoboti, furnizim karburanti aviacioni); - në pozicione të tjera mbështetëse të strukturave të fluturimit, që nuk janë përcaktuar më sipër dhe për të cilat nuk ka përcaktime në lidhjen nr. 5, të këtij vendimi.				18,000	18,000	18,000

Shënim:

1. Funksionet organike për shërbimet tekniko-operacionale të radarëve, përcaktohen sipas specifikimeve në TOP.
2. Funksionet organike për shërbimet mbështetëse në Detashmentin UAV, në bazat ajrore dhe në struktura të tjera të Forcave të Armatosura përcaktohen sipas specifikimeve në TOP.
3. Ushtarakët aktivë në pozicionet “Pilot Komandant Ekuipazhi-H” dhe “Pilot”, të emëruar në strukturat e Forcës Ajrore apo në strukturat e tjera të Forcave të Armatosura, shtesën e përcaktuar sipas kësaj lidhjeje e përfitojnë vetëm në rast se ruajnë gatishmërinë e fluturimit dhe normave sipas Rregullores së Zhvillimit të Fluturimeve të Forcave Ajrore.

Lidhja nr. 4

(Ndryshuar me VKM nr. 619, datë 10.10.2024)

Masa e shtesës për kushte të veçanta pune e shërbimi për ushtarakët e shërbimit aktiv në Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes

Nr.		Pozicioni	Masa e shtesës, (lekë në muaj)
1	Operacional	Drejtor i përgjithshëm. Zëvendësdrejtor i përgjithshëm. Drejtor drejtorie. Përgjegjës/shef sektori. Specialist/inspektor. Specialist për sigurinë elektronike dhe mbrojtjen kibernetike. Ndihmësinsektor. Teknik i mesëm dhe administrator pajisjesh/operator. Teknik për mirëmbajtjen e pajisjeve SIGINT. Shofer autoveture, mjet operacional.	20,000
2	Operacional Mbështetës	Përgjegjës/shef sektori. Analist. Specialist. Operator dhe për administrimin e dokumentacionit. Operator radiozbulues. Operator për kartotekën, databazën dhe ekspeditor. Teknik i mesëm i specialiteteve të ndryshme/operator/shofer. Roje me armë. Përgjegjës roje/shofer dhe roje me armë në ZGJ.	15,000
3	Mbështetës	Për ushtarakët aktivë në funksionet e tjera të AISM-së, të papërfshirë në nëndarjet 1 dhe 2, të kësaj lidhjeje.	13,000

Shënim. Pozicionet e punës në përbërje të strukturave të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, sipas ndarjeve, operacionale, operacionale mbështetëse dhe mbështetëse, përcaktohen sipas specifikimeve në TOP.

Lidhja nr. 5

(Ndryshuar me VKM nr. 619, datë 10.10.2024)

Masa e shtesës për kushte të veçanta pune e shërbimi që përfitojnë ushtarakët e tjerë të shërbimit aktiv, në strukturat e Forcave të Armatosura

Nr.	Ushtarakë të tjerë në strukturat e Forcave të Armatosura që përfitojnë shtesë për kushte të veçanta pune e shërbimi	Masa e shtesës (lekë në muaj)
	1	2
1	Drejtor në njësinë Ushtarake të Sigurisë Kibernetike.	70,000
2	Specialist në njësinë Ushtarake të Sigurisë Kibernetike.	60,000
3	Përgjegjës sektori në njësinë Ushtarake të Sigurisë Kibernetike.	50,000
4	Ushtarakët aktivë në funksionet organike: - Komandant Qendre/komandant moduli/shef/përgjegjës sektori/seksioni në Qendrën Fikse TIK/MM dhe SHPFA, në Agjencinë e Sistemeve të Ndërlidhjes dhe Informacionit. - Komandant Qendre/Komandant moduli/shef/përgjegjës sektori/seksioni në Qendrën Mobil (TIK) në Agjencinë e Sistemeve të Ndërlidhjes dhe Informacionit. - Komandant Qendre/Komandant moduli/shef/përgjegjës sektori/seksioni në Qendrën e Automatizimit, në Agjencinë e Sistemeve të Ndërlidhjes dhe Informacionit Agjencinë e Sistemeve të Ndërlidhjes dhe Informacionit.	40,000

	- Në kompanitë e aksioneve direkte në Batalionin e Forcave Speciale. - Komandant/zëvendëskomandant dhe në funksionet organike me specialitet “Polumbar” në grupin AME të zhytjes në Qendrën e Zhytjes, në Forcën Detare. - “Parashutist”.	
5	Ushtarakët aktivë në funksionet organike: - Komandant Qendre/Moduli dhe mbështetjes me SNI në Agjencinë e Sistemeve të Ndërlidhjes dhe Informacionit. - Administrator infrastrukture (për rrjetet kompjuterike të NATO-s; Web; Databazë virtualizimi; <i>storage back up</i>). - Administrator sistemesh/shërbimesh në Agjencinë e Sistemeve të Ndërlidhjes dhe Informacionit.	35,000
6	Ushtarakët aktivë të Forcës Tokësore dhe Detare, në funksionet organike: - Në Shtabin e Batalionit të Forcave speciale. - Komandant/zëvendëskomandant/shef shtabi/shef i operacioneve dhe stërvitjes, në Regjimentin e Operacioneve Speciale. - Në Kompaninë e Zbulimit, në Regjimentin e Operacioneve Speciale. - Në kompanitë komando, në Batalionin Komando. - Në grupet e bordingut në Forcën Detare. - Në Seksionin e Kurseve dhe Vlerësimit, në Regjimentin e Operacioneve Speciale. - Në pozicionet “Specialist” për TIK/IT, në strukturat e Forcave të Armatosura. - Në grupet/skuadrat/togat dhe kompanitë operacionale të kërkim-shpëtimit (për shuarjen e zjarreve, tërmetejeve, aksidenteve, akomodimit fushor, kërkim-shpëtimit në terrene malore apo në zona ujore) në strukturat e Forcave të Armatosura.	30,000
7	Ushtarakët aktivë në funksionet organike: - “Mjek me specialitet”. - “Mjek i përgjithshëm”. - Në kompaninë EOD në Komandën Mbështetëse; - Në togën EOD në kompaninë e Xhenios në Forcën Tokësore; - Në Qendrën e MADM-së dhe lëndëve të rrezikshme në Forcën Tokësore, si dhe në funksione të njëjta në repartet e tjera në strukturat e Forcave të Armatosura.	25,000
8	Ushtarakët aktivë në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura dhe në aparatit e Ministrisë së Mbrojtjes: - Shef i Shtabit të Përgjithshëm; - Zëvendësshef i Shtabit të Përgjithshëm; - Drejtor i Shtabit të Përgjithshëm; - Drejtor Kabineti. - Këshilltar ushtarak i Presidentit të Republikës së Shqipërisë. - Drejtor drejtorie. Ushtarakët aktivë në funksionet organike: - Komandant/zëvendëskomandant i Forcës Tokësore. - Komandant i Forcës Detare/i Forcës Ajrore/në Komandën e Mbështetjes, në Akademinë e Forcave të Armatosura dhe në Kolegjin e Mbrojtjes dhe Sigurisë. - Në skuadër, togë dhe në kompanitë e këmbësorisë (manovrës)/në strukturat e Forcave të Armatosura. - Në skuadër, togë dhe në kompanitë e mbështetjes me luftim, në strukturat e Forcave të Armatosura. - Në Bateritë e Artilerisë Tokësore. - Në baterinë e mortajave kundërajrore në Regjimentin e Mbështetjes me Luftim në Forcën Tokësore. - Në bateritë e mbrojtjes kundërajrore, në batalionin e mbrojtjes kundërajrore të bazuar në tokë (GBAD).	20,000

	- Në grupet në Flotiljet Detare. - Në Shërbimin Hidrografik ushtarak, që shërbejnë në anije në Forcën Detare. - Në Kompaninë e Ceremonialit/kompaninë e transportit/grupin e sigurisë fizike/në batalionin e mbështetjes së Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura. - Në Orkestrën Frymore dhe në Orkestrën Simfonike të Forcave të Armatosura. - Në Sektorin e Mbikëqyrjes dhe Demontimit të Armatim Municionit, në Qendrën e Menaxhimit të Materialeve. - Të personelit mësimor (pedagog) pa tituj dhe grada, në Kolegjin e Mbrojtjes dhe Sigurisë. Ushtarakët aktivë në funksionet organike të Policisë Ushtarake: - Komandant/zëvendëskomandant dhe Shef Shtabi. - Në sektorin e Policisë Kriminale. - Në pozicionin “agjent” dhe “inspektor” në seksionet e rretheve të Policisë Kriminale; - Në kompaninë e parë, në kompaninë e dytë operacionale dhe në kompaninë operacionale të ruajtjes së personaliteteve të larta shtetërore dhe të objekteve të veçanta. Ushtarakët aktivë në funksionet organike: - Stomatolog/farmacist në strukturat e Forcave të Armatosura.	
9	Ushtarakët aktivë në funksionet organike të aparatit të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura: - Në kabinetin e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm; - Në zyrën e zëvendës-shefit të Shtabit të Përgjithshëm/Drejtorit të Shtabit të Përgjithshëm. Përgjegjës sektori/shef sektori/oficer shtabi/specialist dhe në funksionet/pozicionet nënoficer. Ushtarakët aktivë në funksionet organike: - Në Institutin e Kërkimit Shkencor Ushtarak; - Në degën e kurseve në Qendrën e Arsimit Profesional të Nënoficerëve; - Në Qendrën e Gjuhëve të Huaja. - Në Kursin e stërvitjes individuale bazë dhe të avancuar, në Qendrën e Arsimit Profesional të Ushtarëve. Ushtarakët aktivë në funksionet organike: - Në kompaninë e punimeve xheniere, në kompanitë e urave, në batalionin e xhenios; - Në Detashmentin e Mbështetjes Rajonale Elbasan; - Në Kompaninë Xheniere të Regjimentit të Mbështetjes me Luftim në Forcën Tokësore, pa përfshirë togën EOD. - Personel teknik i shkencave mjekësore, në strukturat e Forcave të Armatosura.	18,000
10	Ushtarakët aktivë në funksionet organike: - Zëvendëskomandant force, në komandat e forcave dhe strukturave mbështetëse (FD, FAj, KM, KMS dhe AFA). - Shef shtabi/shef zyre/shef dege në komandat e forcave dhe strukturave mbështetëse (FT, FD, FAj, KM, KMS dhe AFA). - Komandant, zëvendëskomandant, shef Shtabi në regjimentet e këmbësisë/mbështetjes me luftim, në Forcën Tokësore. - Komandant, zëvendëskomandant, shef shtabi në distriktet detare të Forcës Detare. - Komandant/drejtor, zëvendëskomandant/zëvendësdrejtor/kryetar/zëvendëskryetar, shef Shtabi, shef administrate, në repartet autonome të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura. - Komandant reparti/zëvendëskomandant reparti/shef Shtabi reparti, në nivel batalioni/flotilje/qendre/baze në repartet e varësisë së komandave të forcave dhe strukturave mbështetëse (FT, FAj, FD, KM, AFA). - Në Batalionin komando në flotiljet detare të patrajtuara në këtë lidhje. - Në modulën e mbështetjes me SNI.	15,000

	- Në Qendrën fikse (TIK), (Komandant i Qendrës, Komandant i modulit SNI, moduli SNI në MM/SHP, seksioni IT dhe i shërbimeve, seksioni IT <i>Networks, Storage, Back-up</i>). - Në Qendrën fikse (TIK), (Seksioni <i>Servis Desk</i>, Seksioni i Telekomunikacionit) në Agjencinë e Sistemeve të Ndërlidhjes dhe Informacionit. - Në modulën e pikave të ritransmetimit dhe në Qendrën e Automatizimit në Agjencinë e Sistemeve të Ndërlidhjes dhe Informacionit. - Në Drejtorinë e Projekteve të Automatizimit dhe Inovacionit dhe në Qendrën e Inovacionit të Sigurisë dhe Mbrojtjes në Ministrinë e Mbrojtjes. - Në Detashmentin CIMIC të Forcës Tokësore. - Në Qendrat Stërvitore të Forcave të Armatosura. - Në seksionet e kurseve të Forcave të Armatosura.	
11	Ushtarakët aktivë në funksionet organike: - Shef Seksioni në Regjimentet e këmbësisë, ROS, RML, të Forcës Tokësore, të papërfshira më sipër. - Shef seksioni në bazat ajrore të Forcës Ajrore, të papërfshira më sipër. - Shef Seksioni në Distriktet Detare të Forcës Detare, të papërfshira më sipër. - Në Qendrat Operacionale në Forcat e Armatosura. - Në kompanitë/qendrat/togat/skuadrat/e ruajtjes dhe sigurisë, në strukturat e Forcave të Armatosura. - Nënoficer i Qendrës/operator/administrator/magazini në Qendrën fikse (TIK). - Në Seksionin e Radiostacioneve, Seksioni i Pikës së Përpunimit të Informacionit, Seksioni i Pikës së Dorëzimit të Dokumenteve, Seksioni i Monitorimit të SNI dhe Seksionin SNI Multimedia, në modulën e SNI, në MM/SHP. - pozicionet e tjera në Qendrën Mobil të TIK. - Në grupin e mirëmbajtjes së Helikopterëve në, Forcën Ajrore të papërfshira në lidhjen 3. - Në qendrat e kontrollit - raportimit, në bazat ajrore të papërfshira në lidhjen 3. - Në pozicionet “Administrator i dokumentacionit teknik/specialist dokumentacioni”, në Shërbimin Meteorologjik Ushtarak. - Në bazat dhe vendbazimet detare, të Forcës Detare. - Në Qendrën e Vëzhgimit Detar të Forcës Detare. - Në Shërbimin Hidrografik dhe në Kantierin e Ndërtimit të Anijeve, të Forcës Detare. - Në kompanitë/togat/skuadrat e mbështetjes me shërbime logjistike/mbështetjes së Shtabit dhe në funksione ekuivalente - Në strukturat e Forcave të Armatosura. - Në Qendrën e mbështetjes në ASNI. Ushtarakët aktivë në funksionet organike: - Në Qendrën e Simulimit në AFA - Në shtabet e forcave dhe strukturave mbështetëse (FT, FD, FAj, KM, KMS dhe AFA), të patrajuara më sipër, sipas kësaj lidhjeje, në strukturat e Forcave të Armatosura. - në shtabet në nivel regjimenti, batalioni, distrikti detar, flotilje, grup, detashmenti, qendre, bazat, në strukturat e varësisë së FT, FD, FAj, KM, AFA, të patrajuara më sipër, sipas kësaj lidhjeje në strukturat e Forcave të Armatosura. - Në Inspektoratin e Qarkullimit Rrugor, në seksionin e rendit. - Në sektorin e MNZSH-së; - Në seksionet e rretheve/qarqeve në Policinë Ushtarake. - Në Shtëpitë e Pushimit të Ushtarakëve, në batalionin e Mbështetjes së Shtabit të Përgjithshëm të FA-së. - Në kompaninë e parë dhe të dytë të furnizimit, në togat e mbështetjes, në batalionin e furnizimit të Komandës Mbështetëse. - Në kompaninë e parë dhe të dytë të transportit, në skuadrën e mirëmbajtjes në kompaninë e mbështetjes, në batalionin e transportit në Komandën Mbështetëse.	13,000 13,000

	- Në pozicionet me specialitete detare, të emëruar në pozicione organike, që kërkojnë kryerjen e lundrimeve, në Forcën Detare. - Në postat radioteknike dhe postave sinjal-vrojtuese, në Forcat Detare. - Në strukturat autonome të MM-së dhe SHPFA-së, të patrajtuara më sipër, sipas kësaj lidhjeje. - Në strukturat e tjera të Forcave të Armatosura, që nuk janë përfshirë në asnjë nivel sipas strukturave apo në nivele të tjera të kësaj lidhjeje, si dhe nuk janë të përfshirë në lidhjet nr. 3 dhe nr. 4.	
--	---	--

Shënim:

1. Ushtarakët aktivë, funksioni i të cilëve përmban dy apo më shumë emërtime të pozicioneve të punës, që përfitojnë shtesë për kushte të veçanta pune e shërbimi për çdo emërtim/pozicion, do të trajtohen vetëm me një shtesë sipas kësaj lidhjeje.
2. Ushtarakët aktivë, pjesë e strukturave TIK, që trajtohen me shtesë për kushte të veçanta pune e shërbimi sipas kësaj lidhjeje, shtesën e përcaktuar në këtë lidhje do ta përfitojnë nëse përmbushin dy kriteret e përcaktuara në pikën 9 të këtij vendimi.
3. Në termin “Personeli teknik i shkencave mjekësore” përfshihen pozicionet e përcaktuara në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e punonjësve të personelit mjekësor dhe personelit teknik të shkencave mjekësore, në institucionet/strukturat shëndetësore në varësi të ministrit përgjegjës për shëndetësinë, për mbrojtjen, për drejtësinë dhe për punët e brendshme.

Lidhja nr. 6

Funksionet ushtarake që përfitojnë shtesë për punë të vështirë e të dëmshme në shëndet në strukturat e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë

Nr.	Emërtimi i funksionit	Masa e shtesës lekë në muaj
1	Në laboratorin e municioneve të Laboratorit Qendror të Forcave të Armatosura: Shef i laboratorit; Shef i seksionit; Teknolog kimist; Teknik i specialiteteve të ndryshme.	7,400
2	Në laboratorin e analizave kimike në Laboratorin Qendror të Forcave të Armatosura: Shef i laboratorit; Shef i seksionit; Specialist analizash; Specialist për sintezën; Teknolog kimist. Në Njësinë e Mjekësisë Ushtarake, pranë Spitalit Universitar të Traumës: Mjek anatomopatolog.	5,900
3	Në Njësinë e Mjekësisë Ushtarake, pranë Spitalit Universitar të Traumës: Mjek neurokirurg; Teknik për higjienën e ujit; Teknik për higjienën ushqimore; Inxhinier kimist; Mjek i laboratorit klinik biokimik; Kryelaborant klinik biokimik; Laborant klinik biokimik; Mjek histolog; Laborant histolog.	5,200
4	Në të gjitha strukturat e Forcave të Armatosura: Teknik rendues; Ushtarakët që punojnë në rrjetet kompjuterike LAN/ËAN; Ushtarakët në pikat e ritransmetimit, radiozbulimit dhe pikat e vrojtimit të qendëruara; Inxhinier elektronik; Informaticien. Në Forcat Ajrore: Asistent kontrollor trafiku ajror. Në Njësinë e Mjekësisë Ushtarake, pranë Spitalit Universitar të Traumës: Mjek i higjienës ushtarake dhe inspektor sanitar; Mjek toksikolog; Mjek neuropsikiatër; Kryeinfermier në shërbimin e neuropsikiatrisë; Mjek anesteziatë reanimator; Ndihmës	4,400

	anestezist; Kryeinfermier reanimacioni; Kryeinfermier dhe infermiere të sallave të operacionit të urgjencës dhe të reanimacionit kirurgjikal; Teknik për DDD (Dizinfektim, Deratizim, Dezinsektim); Prozektor. Në Laboratorin Qendror të Forcave të Armatosura: <u>Në seksionin e analizave kimike dhe laboratorin e analizave kimike:</u> Specialist i teknikës dhe aparaturës; Specialist ventilimi; Shofer i mjeteve speciale. <u>Në seksionin e intendencës në laboratorin bakteriologjik:</u> Shef i seksionit; Teknolog kimist; Biokimist. <u>Në seksionin e mjeteve të indikimit në laboratorin e analizave kimike:</u> Specialist për teknikën e aparaturës; Specialist përpunimi qelqi. <u>Në laboratorin e analizave kimike:</u> Magazinier. <u>Në laboratorin e municioneve:</u> Teknik/Shofer.	
5	Në të gjitha strukturat e Forcave të Armatosura: Magazinier; Nënoficer furnizimi që merret me karburante; Pilot avioni; Pilot helikopteri; Polumbar (zhytës). Në strukturat xheniere: Manovrator dhe ndihmës manovrator i makinerive të rënda: (buldozer, eskavator, rulist, motorulist, vinçier, autovinçier, etj.) Në Njësinë e Mjekësisë Ushtarake, pranë Spitalit Universitar të Traumës: Mjek radiolog; Mjek depistim radiologjik; Mjek pneumolog; Laborant teknik në shërbimin e radiologjisë; Oksigjenist; Elektricitist; Specialist mirëmbajtjes pajisjeve mjekësore. Në Laboratorin Qendror të Forcave të Armatosura: Drejtor; Zv/drejtor. Në Agjencinë e Sistemeve të Nderlidhjes e Informacionit: Teknik kabllist i rrjetit të jashtëm; Radist; Radiorelist; Operator; Specialist SUE (stacioni i ushqimit elektrik)	3,700
6	Në strukturat xheniere: Motokompresorist; Pistoletist; Ndihmës motokompresorist; Ndihmës pistoletist; Në Njësinë e Mjekësisë Ushtarake, pranë Spitalit Universitar të Traumës: Mjek fizioterapeut; Mjek hematolog; Mjek, kryeinfermier e infermier në shërbimin e urgjencës dhe të pranimit; Mjek infeksionist; Mjek reanimacion terapisë; Mjek epidemiolog; Teknikien i mjekësisë Forcave Ajrore (Aviacionit); Teknikien i mjekësisë Forcave Detare (Marinës); Masazhist në fizioterapi. Në Forcat Detare: Shef stacioni akustik; Instruktor; Laborant navigacioni; Radiometrist; Mirëmbajtës kuvertash; Nënoficeri planshetës operatore. Në Batalionin e Vëzhgimit Ajror: Komandanti i batalionit; Zv/komandanti i batalionit; Shef zbulimi i batalionit; Shef/Oficer shtabi operacional i batalionit; Specialist mirëmbajtje radar në batalion; Specialist mirëmbajtje radar në qendrat e vëzhgimit ajror; Shef i qendrës së vëzhgimit ajror; Zv/Shef i qendrës së vëzhgimit ajror; Komandant radari; Shef seksioni i përpunimit të të dhënave; Nënoficer i kontrollit të ekranit RD (radarit); Nënoficer i përpunimit dhe transmetimit të informacionit; Nënoficer i teknikës speciale; Teknik mirëmbajtje për radarët; Ushtarakë në Qendrën Operacionale të Vëzhgimit Ajror. Në Qendrën Operacionale të Sovranitetit Ajror: Shefi Qendrës Operacionale të Sovranitetit Ajror; Shefi i seksionit të drejtimit; Specialist ndërlidhje; Specialist i kontrollit të trafikut ajror; Specialist për mbrojtjen ajrore.	3,000
7	Në të gjitha strukturat e Forcave të Armatosura: Të gjitha funksionet organike, në përbërje të cilave është emërtimi “operator”; Teknik kabllist i rrjetit të brendshëm; Kabllist; Specialist i linjave telefonike; Kryeoperator; Baterist; Saldator i saldimit me oksigjen; Laborant kimist; Specialist laborant kimist; Shofer autoboti karburanti; Elektricitist; Telefonist i qendrës së ndërlidhjes; Ushtarakët e kompanive (qendrave) të ndërlidhjes që punojnë në tunele; Shef radiostacioni; Elektroaut baterist;	2,200

Elektroakumulatorist; Radist; Centralist; Nënoficer i radios; Radiorelist; Radiometrist; Magazinier i lëndëve helmuese luftarake; Shef i PVQ (pikë vrojtimi qendror); Specialist riparim/mirëmbajtje të mjeteve kompjuterike; Specialist i administrimit të rrjeteve kompjuterike.

Në Forcat Tokësore: Instruktor teknike (tanke).

Në Forcat Ajrore:

Specialist për vlerësim me mjete radioteknike; Ushtarakët në shërbimin meteorologjik; Ushtarakët e mirëmbajtjes në skuadrilje dhe në qendrat e mirëmbajtjes; Shef zbulimi në komandën e shtabin e Forcës.

Në sektorin e kontroll kolaudimit në laboratorin e analizave kimike në Laboratorin Qendror të Forcave të Armatosura: Shofer mekanik.

Në Njësinë e Mjekësisë Ushtarake, pranë Spitalit Universitar të Traumës:

Mjek specialist në specialitet e terapisë; Mjek kirurg në specialitet e kirurgjisë; Mjek mikrobiolog; Mjek higjenist dietolog; Mjek në poliklinikë; Mjek stomatolog; Kirurg maxiofacial; Otorinolaringolog; Okulist; Mjek ortoped traumatolog; Kryeinfermier; Kryeinfermier i përgjithshëm; Infermier; Farmacist; Laborant në shërbimin e mikrobiologjisë.

Ushtarakët në **Orkestrën Frymore të Forcave të Armatosura.**

Në strukturat xheniere: Specialist duralumini; Agregatist.

Në Forcat Detare: Oficer shtabi për lokacion; Specialist analize informacioni sigurisë; Specialist lokacioni, analize informacioni siguri; Nënoficer mirëmbajtjes vëzhgimit detar; Shef ndërlidhje lokacioni; Specialist/operator lokacioni; Komandant, Zv/komandant, Shef organi në anije; Teknik riparues lokacioni; Komandant skuadre lokacioni; Radist; Radiometrist; Specialist SUE (stacion ushqimit elektrik); Komandant kompanisë vëzhgimit detar; Komandant PRT (poste radioteknike); Nënoficer analize informacioni; Motorrist; Kryemotorrist; Përgjegjës kuverte; Mitrulier në anije; Infermier në anijen polumbare; Hambarist; Elektracist; Kaldaist; Kuzhinier në anije; Ushtarakë në dokun lundrues të kantierit i riparimit të anijeve.

Në Arkivin Qendror: Arkivist; Shef i laboratorit të mikrofilmit.

Në Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes:

Ushtarakë në zyrën e mbështetjes teknike.

Në qendrën e Mirëmbajtjes në Detashmentin Ajror:

Komandant qendre mirëmbajtje; Zv/komandant qendre mirëmbajtje; Specialist radio e pajisjeve speciale; Shef seksioni shfrytëzimi;

Shef seksioni specialiteteve; Shef seksioni mirëmbajtje; Nënoficer shfrytëzimi; Nënoficer pajisjeve Speciale Radio Armatime.

Kompania e riparimeve në batalionin logjistik të Forcave Ajrore:

Komandant i kompanisë; Shef i seksionit riparim armatimit; Shef i seksionit riparim auto; Shef i seksionit riparimit radar-ndërlidhje; Specialist për SDT (stacion drejtimi topave), ADZAKA (aparati i drejtimit zjarrit artilerisë kundër ajrore), RDKA (raketa drejtimit kundër ajror), ISPIL (instrumnta të lëvizshëm të raketave); Shef i seksionit rigjenerimit karburantit special; Laborant i analizave karburantit special; Laborant karburanti special avioni.

Në Qendrën stacionare të ndërlidhjes të Agjencinë e Sistemeve të Nderlidhjes e Informacionit:

Komandanti; Zëvendëskomandanti; Nënoficer për furnizimin; Specialist teknik.

Në Bazën e Riparimit të Aviacionit:

Specialist në sektorin e kontrollit të cilësisë e laboratorit; Shef i kontrollit mekanik dhe sigurimit teknik; Shef/specialist mekanik; Shef/specialist përpunues; Shef i riparimit të agregatëve hidraulikë; Shef/specialist i riparimeve elektrike; Shef/specialist riparim motori; Shef/specialist prodhimi tornitor; Shef/specialist galvanizimi; Shef/specialist riparimi elektrogazi.

	Në Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes: Operator radiozbulues në Qendrën e Radiozbulimit. Në Institutin e Gjeografisë dhe Infrastrukturës Ushtarake: Specialist topogjeodet;Ushtarakë në seksionin e laboratorit dhe shtypit.	
8	Në të gjitha strukturat e Forcave të Armatosura: Shofer autoambulance; Shef karrofiçine; Fotograf; Bojaxhi; Marangoz; Specialist druri; Specialist duralumini; Veteriner; Specialist mirëmbajtje (mekanik, tornitor,kovaç, motorist, frezator, xhenerik, hekurkthyes;ribatinist); Specialist/nënoficer mbrojtjes konder kimike/MADM;Specialist në kartotekë;Telefonist i qendrës ndërlidhjes; Shef shëndetësisë; Mjek; Farmacist;Ndihmës farmacist; Ndihmësmjek; Infermier; Kryeinfermier; Arkivist;Specialist arkivi;Shef sekretarisë, shifrës dhe arkivit; Shef i sektorit të administrimit të dokumentave;Ushtarakë në sektorin e evidencë (kartotrekës) në Shtabin e Përgjithshëm. Në Njësinë e Mjekësisë Ushtarake, pranë Spitalit Universitar të Traumës: Teknicien i përgatitjes edukimit shëndetësor; Magazinier; Nënoficer furnizimi. Në të gjitha strukturat xheniere: Hekurkthyes; Ndihmëshekurkthyes. Në qendrën e Mirëmbajtjes në Detashmentin Ajror: Specialist elektrogazi dhe furnizimi; Specialist shfrytëzimi; Nënoficer shfrytëzimi; Specialist radio; Specialist armatimi; Specialist i pajimeve speciale. Në Batalionin e Vëzhgimit Ajror: Mekanik; Specialist auto; Nënoficer për riparimin e teknikës; Komandant i skuadrës së transportit e mirëmbajtjes; Specialist mirëmbajtje. Në Forcat Detare: Komanda e shtabi i flotiljeve; Komanda e grupeve lundruese; Në Shtabin e Distriktit Detar: Komandant; Zv/komandant; Shef shtabi; Shef operacioneve; Shef zbulimi; Shef ndërlidhje; Specialist lundrimi. Ushtarakë të tjerë në Qendrën e Bashkuar Operacionale. Në Qendrën Kulturore të Forcave të Armatosura: Ushtarak në grupin artistik.	1,500
9	Në të gjitha strukturat e Forcave të Armatosura: Saldator me elektrik; Kryekuzhinier; Kuzhinier; Kaldaist; Specialist mirëmbajtje (gomist, saldator, axhustator, grasatorist, lavazhier, hidraulik).	800